



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë dhe Çështje lidhur me Të

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtësit (Kujdestar) të Hashim Thaçit
Mbrojtësit Kujdestar të Bashkim Smakajt
Mbrojtjes së Isni Kilajt
Mbrojtësit Kujdestar të Fadil Fazliut
Mbrojtësit Kujdestar të Hajredin Kuçit

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 20, 21(2) dhe 39(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Ndërmjet 15 dhjetorit 2023 dhe 12 nëntorit 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i dorëzoi Gjykatësës së Procedurës Paraprake për konfirmim aktakuzat kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Bashkim Smakajt (“z. Smakaj”), Isni Kilajt (“z. Kilaj”), Fadil Fazliut (“z. Fazliu”) dhe Hajredin Kuçit (“z. Kuçi”).²

2. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendim ku konfirmoi (pjesërisht) akuzat kundër zotërinjve Thaçi, Smakaj, Kilaj, Fazliu dhe Kuçi për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit.³ Të njëjtën ditë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu lëshoi fletarrestimet për zotërinjtë Thaçi, Smakaj, Kilaj dhe Fazliu dhe fletëthirrjen për paraqitje për z. Kuçi.⁴ Sa i takon z. Kuçi,

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, konfidencial.

² KSC-BC-2023-12, F00002, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesës Lidhur me Të*, 15 dhjetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00007, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim*, 11 mars 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00017, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Konfirmim*, 28 qershor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00028, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar më Tej për Konfirmim*, 12 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse (“Vendimi për Arrestime dhe Fletëthirrje”)*, 29 nëntor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake e urdhëroi të paraqitet para Dhomave të Specializuara (“DHS”) të hënën, 9 dhjetor 2024, në orën 10:00.⁵

3. Më 2 dhjetor 2024, ZPS-ja parashtrroi aktakuzën e konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”).⁶

4. Më 5 dhjetor 2024, ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu në Kosovë.⁷ Të njëjtën ditë, ZPS-ja i dorëzoi z. Kuçi fletëthirrjen për paraqitje.⁸ Më vonë atë ditë, Administratorja i dorëzoi fletarrestimin z. Thaçi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).⁹ Bashkë me fletarrestimet dhe fletëthirrjen, të akuzuarve iu dorëzua edhe Aktakuza e Konfirmuar.¹⁰

5. Më 6 dhjetor 2024, me urdhër të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹¹

⁵ Shtojca 5 e Vendimit për Arrestime dhe Fletëthirrje.

⁶ KSC-BC-2023-12, F00040, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 2 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00042, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00043, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Isni Kilajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00045, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Fadil Fazliut sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00046, Administratorja, *Njoftim për Dorëzimin e Fletëthirrjes për Paraqitje për Hajredin Kuçin*, 5 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00048, Administratorja, *Njoftim për Dorëzimin e Fletarrestimit për Hashim Thaçin sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁰ *Shih* Vendimin për Arrestime dhe Fletëthirrje, para. 106-108.

¹¹ *Shih* Vendimin për Arrestime dhe Fletëthirrje, para. 111.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARAQITJA E PARË DHE RISHIKIMI I ARRESTIMIT/PARABURGIMIT

6. Në bazë të nenit 39(4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestit ose fletarrestimit të lëshuar nga DHS-ja, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret në ndalim, informohet menjëherë për akuzat kundër tij dhe transferohet në DHS. Nëse nuk është lëshuar fletarrestimi dhe nëse është në liri, i akuzuari thirret për t'u paraqitur personalisht ose përmes videolidhjes në shqyrtimin fillestar para DHS-së.

7. Në bazë të rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen e parë. Paraqitja e parë sipas rregullës 92 të Rregullores bëhet brenda shtatë (7) ditësh pasi të akuzuarit i është dorëzuar aktakuza.

8. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat – ku përfshihet edhe seanca e paraqitjes së parë të të akuzuarit – janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.

9. Në bazë të nenit 41(5) të Ligjit dhe rregullës 55(6) të Rregullores, personi i privuar nga liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet me mënyrën e udhëtimit të specifikuar në urdhrin e Dhomave të Specializuara dhe sillet para gjykatësit të Dhomave të Specializuara pa vonesë dhe ka të drejtën për shqyrtim gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme ose për t'u liruar në pritje të shqyrtimit gjyqësor.

B. GJUHËT E PUNËS

10. Në bazë të nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të DHS-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja. Në proceset gjyqësore, paneli mund të vendosë

gjuhët e punës për procesin gjyqësor përkatës, sipas nevojës dhe në përputhje të plotë me të drejtat e të akuzuarit të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit.

11. Në bazë të rregullës 8(3)(a) të Rregullores dhe duke mbajtur parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

C. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

12. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjeve gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

13. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

III. DISKUTIM

A. PARAQITJA E PARË

14. Duke marrë parasysh se: (i) zotit Thaçi iu dorëzua fletarrestimi së bashku me Aktakuzën e Konfirmuar në objektin e paraburgimit të DH-së më 5 dhjetor 2024; dhe

(ii) zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu u arrestuan më 5 dhjetor 2024 dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së më 6 dhjetor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme - duke mbajtur parasysh të drejtën e personit të arrestuar për të dalë para gjykatësit pa vonesë të papërligjur - që seancat e paraqitjes së parë të të akuzuarve të mbahen **të dielën, më 8 dhjetor 2024**. Seanca e paraqitjes së parë të z. Thaçi do të fillojë në orën **09:30**. Seancat e paraqitjes së parë përkatësisht të zotërinjve Smakaj, Fazliu dhe Kilaj, do të kryhen menjëherë më pas, në këtë renditje, me gjysmë ore pushim ndërmjet tyre. Për rrjedhojë, në lidhje me zotërinjtë Smakaj, Fazliu dhe Kilaj, palët duhet të jenë të disponueshme dhe të gatshme për të vijuar që nga ora **10:30**.

15. Administratorja do të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të siguruar transferimin dhe transportimin e të akuzuarve nga objekti i paraburgimit i DHS-së në mjediset e DHS-së në përputhje me orarin e caktuar më sipër dhe duke mbajtur parasysh udhëzimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në paragrafin 108 të Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse.

16. Lidhur me z. Kuçi, rikujtoj se seanca e paraqitjes së parë të tij do të mbahet **të hënën, 9 dhjetor 2024, në orën 10:00**.¹²

17. Gjithashtu, duke pasur parasysh se seancat mund të jenë publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografive në fillim të secilës seancë të paraqitjes së parë.

B. GJUHËT E PUNËS

18. Në përputhje me të drejtat e të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit, është e nevojshme të caktohet gjuha e punës në këtë proces gjyqësor, për të garantuar kryerjen e drejtë, efikase dhe të shpejtë të tij. Për këtë qëllim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake

¹² Shtojca 5 e Vendimit për Arrestime dhe Fletëthirrje.

urdhëron palët që në seancat e paraqitjes së parë, të paraqesin gojarisht mendimet e tyre në lidhje me gjuhën e punës.

19. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se deri më tani, gjuha e punës në këtë proces ka qenë anglishtja, meqenëse të gjitha parashtrimet e ZPS-së dhe Administratores, si dhe vendimet dhe urdhrat e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, janë bërë në anglishte. Pasi të ketë marrë mendimet e palëve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të vendosë nëse ka arsye bindëse për të mos përdorur anglishten si gjuhë të punës.

20. Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se caktimi i gjuhës së punës së procesit nuk ndikon në gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për përdorim nga të akuzuarit.¹³

C. DATA E KONFERENCËS MBI ECURINË E ÇËSHTJES

21. Gjykatësja e Procedurës Paraprake informon palët se synon të mbajë konferencë mbi ecurinë e çështjes **të martën, 17 dhjetor 2024, në orën 14:00**. Urdhri për caktimin e datës dhe rendit të ditës të kësaj konference do të lëshohet në kohën e duhur pas paraqitjes së parë të të akuzuarve. Mbrojtja ftohet që gjatë seancave të paraqitjes së parë të bëjë të ditur gojarisht nëse mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit kanë ndërmend të marrin pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes duke qenë fizikisht të pranishëm ose përmes videokonferencës, sikurse përcaktohet në rregullën 96(2) të Rregullores.

IV. VENDIM

22. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

¹³ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; Rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.

- (a) **VENDOS** të mbajë seancat e paraqitjes së parë të zotërinjve Thaçi, Smakaj, Fazliu dhe Kilaj të **dielën, 8 dhjetor 2024**, sikurse përcaktohet në paragrafin 14 më lart;
- (b) **URDHËRON** Administratoren të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të siguruar transferimin dhe transportimin e të akuzuarve nga objekti i paraburgimit i DHS-së në mjediset e DHS-së, në përputhje me paragrafin 15 më lart;
- (c) **RIKUJTON** se seanca e paraqitjes së parë të z. Kuçi do të mbahet të **hënën, 9 dhjetor 2024, në orën 10:00**;
- (d) **AUTORIZON** Administratoren të organizojë, në fillim të secilës seancë të paraqitjes së parë, bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë;
- (e) **URDHËRON** palët që, në secilën seancë të paraqitjes së parë, të paraqesin gojarisht parashtrimet e tyre në lidhje me gjuhën e punës që do të miratohet në këtë proces, sikurse përcaktohet në paragrafin 19 më lart; dhe
- (f) **INFORMON** palët se konferenca mbi ecurinë e çështjes do të mbahet të **martën, 17 dhjetor 2024, në orën 14:00**, sikurse përcaktohet në paragrafin 21 më lart.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premte, 6 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.